



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:215521

Datë: 18.02.2025

Numri i dokumentit: 06860812

P.nr.226/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me bashkëpunëtoren profesionale Nazmije Maxhera Paci, në çështjen penale kundër të pandehurit F.A. me adresë në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Vushtri, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1649/23, të datës 11.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljes së aktgjykimit me datën 05.02.2025, më datë 18.02.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F.A., nga i ati B..., e ëma Z..., e vajzërisë K..., data e lindjes ..., në Vushtri, ku edhe jeton, në rrugën “...”, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer klasën e 7 të shkollës fillore, edhe më parë i gjykuar;

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 14.02.2023, rreth orës 18:40, në rrugën “Marin Barleti” në Vushtri, të pandehurit pa autorizim posedojnë substancë narkotike, ashtu që, zyrtarët policor, gjatë patrullimit e kanë ndaluar veturën Golf IV, me targa 02-337-ER, ngjyrë hiri, të cilin e drejtonte F.Z., ndërsa pasagjer i kësaj veturë ishte E.S., F.A. dhe A.M., me rastin e kontrollimi, te i pandehuri A.M. kishin gjetur një sasi me substancë narkotike marihuanë, të cilën kishte qenë duke e përgatitur për konsumim, i pandehuri F.A. e kishte hedhur një sasi me substancë narkotike marihuanë i cili e kishte hedhur tek këmbët e tij, kurse me rastin e kontrollimit të veturës është hasur në një sasi të konsiderueshme të substancës narkotike me marihuanë dhe i pandehuri F.Z. kishte pohuar se është e tij, të cilat substanca janë sekuestruar nga zyrtarët policor dhe pas ekzaminimit të kësaj substance në laborator të Forenzikës është konstatuar se është substancë narkotike e llojit kanabis-marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto 6.15 gram.

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe nenit 269 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449, 452 të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajve si dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej gjashtëqind (600.00) euro, të cilat dënime do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mundet që t'ia paguaj gjobën, gjykata, të njëjtën do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50.00) Euro dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën njëzet (20) Euro. Të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr.1649/23, të datës 11.10.2023, kundër të pandehurve A.M. me adresë në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, Fesnik Zenuni me adresë në rrugën “...” në Vushtrri dhe F.A. me adresë në rrugën “...” në Vushtrri, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 30.04.2024, në të cilin shqyrtim i pandehuri A.M. e ka pranuar fajësinë dhe për të njëjtin është shpallur aktgjykimi në një procedurë të veçuar, kurse sa i përket të pandehurit F.Z. për shkak se i është shmangur paraqitjes në gjykatë për të njëjtin gjykata ka lëshuar urdhër arrest dhe është veçuar procedura, ndërsa i pandehuri i F.A. pas njoftimit me të drejtat e tij nga ana e gjykatës dhe pasi që i është lexuar aktakuza dhe ka deklaruar se të njëjtën e ka kuptuar, është deklaruar i pafajshëm. Në këto kushte gjyqtari i vetëm gjykues të pandehurin e ka njoftuar lidhur me veprimet të cilat mund ti ndërmar pas mospranimit të fajësisë e deri në shqyrtimin gjyqësor, përkatësisht të drejtën për të ushtruar brenda afatit ligjor kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhje të aktakuzës.

Pretendimet e palëve

Me qenë se i pandehuri gjykatës nuk i ka paraqitur kundërshtimin e provave dhe as kërkesën për hedhje të aktakuzës, gjykata shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale e ka caktuar dhe mbajtur me datë 05.02.2025, në të cilin shqyrtim kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Vyrtyste Gërvalla, i pandehuri F.A., si dhe dëshmitarët – zyrtarët policor N.Sh. dhe M.B..

Të pandehurit edhe njëherë pas informimit nga gjykata për të drejtat e tij, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë.

Prokurori i Shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e administrimit të provave do të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri F.A. e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se kjo do të vërtetohet në radhë të parë me dëgjimin e dëshmitarëve – zyrtarëve policor të cilët kanë qenë prezent në ditën kritike kur ka ndodhur rasti, e të cilët njëkohësisht janë dëshmitar okular pasi që nga raportet e përpiluara nga ana e tyre të datës 14.02.2023, është konstatuar se këtu i pandehuri me rastin e kontrollimit nga ana e policisë substancën narkotike e ka hedhur nga dora ku e ka pasur në posedim, tek këmbët ku ishte ulur në veturë. Se kjo substancë përbën substancë narkotike sipas prokurores së shtetit vërtetohet edhe nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 14.02.2023, e që ky vërtetim do të administrohet si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ndër të tjera ka deklaruar se pas administrimit të provave në këtë çështje penale u vërtetua pa asnjë mëdyshje standardi i dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze dhe kjo fillimisht u vërtetua nga dëgjimi i dëshmitarëve – zyrtarëve policor M.B. dhe N.Sh. të cilët plotësisht e kanë mbështetur raportin e përpiluar nga ana e tyre në raport me të pandehurin e me theks të veçantë se i pandehuri ditën kritike ka pasur në posedim substancë narkotike, e cila nga ana e tij është hedh pasi që i njëjti është hasur nga zyrtarët policor. Si provë tjetër që vërteton fajësinë e të pandehurit sipas prokurores së shtetit është edhe vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 14.02.2023, në të cilin përveç përkrahimit të llojit të marihuanës, është përkrahur edhe vendi ku është gjetur substanca në veturë, përkatësisht në ulësen e pasme e që sipas prokurores së shtetit gjene mbështetje dhe është në përputhje të plotë me deklarin e dy dëshmitarëve të dëgjuar. Se substanca e gjetur është substancë narkotike ka deklaruar se vërtetohet edhe nga raporti i datë 27.07.2023, i ekspertimit i AKF-së, ku është konstatuar se substanca është e llojit marihuanë me peshë neto afërsisht 0.15 gram, substancë kjo që është sekuestruar ditën kritike dhe si provë i përgjigjet të tre të pandehurve përkundër që është veçuar procedura. Më tutje ka shtuar se me rastin e shpalljes fajtor të të pandehurit dhe përcaktimin llojit dhe lartësisë së dënimit, ti merret si rrethanë rënduese e kaluara e tij kriminale në raport me veprat e njëjta penale dhe fakti se i njëjti edhe pse është dënuar në vazhdimësi për vepra të kësaj natyre ku mund të ketë më shumë se 5 aktgjykime të formës së prerë, prap se prap përsërit vepra të tilla penale ashtu që qëllimi i dënimit nuk mund të realizohet. Gjithashtu ka propozuar që si rrethanë rënduese të merret shkalla e lartë e dashjes e cila del nga vetë rrjedha e ngjarjes në ditën kritike ku i pandehuri përkundër faktit që mban në posedim substancë narkotike me veprimet e veta në vazhdimësi që i referohen zyrtarëve policor, çka si të tilla të gjitha këto pa asnjë mëdyshje tregojnë dashjen direkte në veprimet e tij, ndërsa ka deklaruar që nuk ka gjetur asnjë rrethanë

lehtësuese që mund ti merret parasysh të pandehurit andaj ka propozuar që ndaj të njëjtit të shqiptohet dënim me burgim efektiv.

I pandehuri në fjalën hyrëse ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë fillimisht në stacion policor në Vushtri, e më pas A.M. i kishte thënë “hajde ta pështjelli një cigare – narkotik”, të cilën e ka mbështjellur por që ai nuk e kishte marrë dhe se posa ka hyrë në veturë kishin ardhur policia, vetura ka qenë ndalur, vetura ka qenë e F.Z.t, ku një sasi të narkotikëve sipas të pandehurit policia e kishin gjetur tek ulësja ku ka qenë ai ulur dhe personi tjetër E.S., ndërsa disa copëza – grimca të substancës i kanë gjetur afër këmbëve të tija. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron pran deklaramëve të mëhershme se nuk e ka kryer veprën penale.

Provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të pandehurit si dhe faktet në favor të tij duke i mundur të pandehurit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, ashtu që gjatë shqyrtimit gjyqësor bëri administrimin e këtyre provave:

Provat materiale: Raporti policor me numër të rastit BD-118 i datës 14.02.2023, Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datë 14.02.2023, Lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës e datë 14.02.2023, Raporti i ekspertimit i AKF-së i datë 27.07.2023, si dhe;

Provat personale: Dëgjimin e dëshmitarit M.B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datë 05.02.2025, dëgjimin dëshmitarit N.Sh. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datë 05.02.2025, leximin e procesverbalit të marrjes në pyetje të dëshmitarit E.S. të dhënë në polici me datë 11.07.2023, leximin e procesverbalit të marrjes në pyetje të F.A. të dhënë në polici me datë 14.02.2023.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Faktet jo kontestuese

Për gjykatën është fakt jo kontestues se me datë 14.02.2023, rreth orës 18:40, në rr.”Marin Barleti”, në Vushtri, i pandehuri F.A. së bashku me F.Z., E.S. dhe A.M., duke qenë në një veturë të përbashkët ishin ndalur nga policia dhe me rastin e kontrollimit tek A.M. kishin gjetur një sasi të substancës narkotike, ndërsa një sasi e narkotikut ishte tek ulësja e pasagjerit, përkatësisht tek këmbët e të pandehurit, ndërsa me rastin e kontrollimit të veturës ishte gjetur një sasi e konsiderueshme e substancës narkotike.

Të gjitha këto fakte të pohuara edhe nga vetë i pandehuri.

Faktet kontestuese

Fakt kontestues për gjykatën dhe i domosdoshëm për tu provuar ishte fakti në qoftë se substanca e gjetur tek këmbët e të pandehurit a ishte në posedim të tij dhe a e kishte hedhur i pandehuri substancën tek këmbët e tij me rastin e kontrollimit nga policia, ashtu siç përshkruhet në dispozitiv të aktakuzës.

Si i ka vërtetuar gjykata faktet kontestuese

Me qenë se i pandehuri me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë, nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, gjykata për vërtetimin e faktit kontestues të lartë cekur, si element qenësor për përmbushjen e figurës së veprës penale me të cilën ngarkohet i pandehuri, ka zhvilluar procedurën e provave, ku ka administruar këto prova:

Provat personale

▪ Dëgjimi i dëshmitari – zyrtarit policor M.B., i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datë 05.02.2025, në pyetjet e parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se me datën kur ka ndodhur rasti ka qenë në njësinë patrulluese në Stacionin Policor në Vushtrri, rasti nuk i kujtohet në detaje për shkak të ekzistimit të rasteve të shumta dhe kohës së gjatë të kaluar mirëpo ka deklaruar se qëndron në tërësi pran raportit të përpiluar me shkrim ku është edhe nënshkrimi i tij i tretë me radhë. Më tutje me rastin e leximit nga ana e prokurores së shtetit të një pjese të raportit ku theksohet se “ne kemi urdhëruar personin F.A., që të zbres nga automjeti dhe i njëjti nga dora ka hedhur një sasi të dyshuar të llojit marihuan tek këmbët ku ishte ulur në ulësen e pasme të majtë..” dhe i pyetur se a qëndron pran këtij konstatimi, dëshmitari ka deklaruar se qëndron në atë se çka është thënë në raport pavarësisht se nuk i kujtohet pasi kanë kaluar 2 vite dhe pasi që kthehet nga i pandehuri dhe e shikon, e konfirmon se i njëjti ka qenë në atë veturë në rastin konkret. Në anën tjetër i pandehuri ka deklaruar se nuk ka pyetje për dëshmitarin e as nuk e ka kundërshtuar dëshminë e të njëjtit.

- Nga deklarata e këtij dëshmitari u vërtetua se i njëjti kishte qenë pjesëmarrës në njësinë patrulluese të datës 14.02.2023, ku kishin ndalur për kontroll dhe kishin ndalur automjetin ku kishte qenë edhe i pandehuri dhe gjatë kontrollit kishin vërejtur të pandehurin F.A. që kishte hedhur substancën narkotike tek këmbët. Për dëshmitarin ishte i identifikueshëm i pandehuri në momentin kur e ka parë si dhe i qëndroj pran raportit policor të përpiluar në ditën kur ka ndodhur rasti.

▪ Dëgjimi i dëshmitari – zyrtarit policor N.Sh., i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datë 05.02.2025, në pyetjet e parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se për rastin për të cilin bëhet fjalë ka qenë në njësinë patrulluese dhe i kujtohet i pandehuri sepse disa herë e kishin arrestuar për vepra të natyrës së njëjtë, ndërsa rreth ditës kritike pavarësisht se nuk i kujtohen detaje për shkak të kohës së gjatë të kaluar, i kujtohet se kishin qenë 4 zyrtar policor në patrullim ku i kishin zënë 4 persona në veturë dhe në mesin e tyre ishte edhe i pandehuri dhe me s ai kujtohet kishin gjetur substancë narkotike tek ulësja e pasagjerit por edhe një sasi të konsiderueshme në bagazh. Me rastin e leximit nga prokurorja e shtetit të raportit të përpiluar

dhe atë në pjesën ku thuhet se “ne kemi urdhëruar personin F.A., që të zbres nga automjeti dhe i njëjti nga dora ka hedhur një sasi të dyshuar të llojit marihuan tek këmbët ku ishte ulur në ulësen e pasme të majtë..”, dëshmitari ka deklaruar se qëndron pran raportit policor sepse raporti është shkruar ashtu siç ka ndodhur rasti, ndërsa ka shtuar se nënshkrimi i dytë në raport është i tij. Ndërsa i pandehuri nuk kishte pasur pyetje për dëshmitarin.

- Nga deklarata e këtij dëshmitari u vërtetua se i njëjti po ashtu kishte qenë pjesëmarrës në njësinë patrulluese të datës 14.02.2023, se e njeh të pandehurin për shkak të rasteve të tjera të natyrës së njëjtë për të cilat ishte arrestuar i pandehuri edhe më parë dhe se i qëndron pran plotësisht raportit policor të hartuar nga ekipa policore në mesin e të cilëve nënshkrues ishte edhe ai.

▪ I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor të datë 05.02.2025, ka deklaruar se dëshiron të shfrytëzoj të drejtën e tij që të mbrohet në heshtje.

▪ Deklarata e të pandehurit e dhënë në polici me datë 14.02.2023, në të cilën i pandehuri kishte deklaruar se lidhur me rastin e asaj dite me shokët e tij kishin dashur ta pështjellin nga një cigare me bari sepse ai e përdor, por që i kishin ndaluar policia dhe gjatë kontrollit e kishin gjetur “do bari” nën ulëse të kerrit mbrapa por që ai nuk e kishte ditur se është aty. Më tutje ka deklaruar se vetura ka qenë e F.Z.t, të cilin e ka shok dhe e njeh tash e 2-3 vite, ndërsa ka shtuar se barin e përdor qe 11 vite dhe nuk mundet të rri pa të.

- Nga kjo deklaratë e të pandehurit u vërtetua se i njëjti është përdorues i rregullt i substancave narkotike dhe edhe ditën kritike qëllimi që ishin bashkuar me të dyshuarit e tjerë kishte qenë që të konsumojnë narkotik, pavarësisht që në anën tjetër mohon ta ketë hedhur narkotikun nga dora dhe sasinë që është gjetur tek ulësja të ketë qenë e tij.

▪ Deklarata e dëshmitarit E.S. e dhënë në polici me datë 11.07.2023, në të cilën dëshmitari kishte deklaruar se ka qenë më parë përdorues i narkotikëve por tani nuk është më dhe është e vërtetë se ditën kritike në veturën e tyre në të cilën kishin qenë bashkë me F.Z.n, A.M.n dhe F.A.n, ishte gjetur 1 qese marihuanë gjatë kontrollit nga policia. Më tutje kishte deklaruar se nuk e di se të kujt ka qenë marihuana e cila është gjetur në veturë, nuk ka qenë e tij dhe nuk e ka ditur që është në veturë, ndërsa substanca që është gjetur në veturë është gjetur afër F.A.t por që nuk e ka parë duke e hedhur, ndërsa në momentin që janë ndaluar nga policia ai ka qenë duke ngrenë bukë mbrapa në veturë, kurse A.M. ka qenë duke e përgatitur një cigare me marihuanë.

Provat materiale

▪ Raporti policor me numër të rastit BD-118 i datës 14.02.2023.

- Nga ky raport policor vërtetohet se katër zyrtarët policor që kishin qenë në patrullim në rr.”Marin Barleti”, kishin ndaluar veturën “Golf IV”, ngjyrë hiri me targa 02-337-ER, ku kanë qenë prezent katër personat dhe atë F.Z. në cilësinë e shoferit, A.M., E.S. dhe F.A.. E që lidhur me të pandehurin F.A. i njëjti ishte urdhëruar nga zyrtarët policor që të zbres nga automjeti dhe i njëjti nga dora kishte hedhur një sasi të narkotikut – marihuanë tek këmbët ku ishte ulur në

ulësen e pasme të majtë, me ç'rast edhe ishte arrestuar, ndërsa në bagazhin e veturës ishte gjetur edhe një sasi e konsiderueshme e narkotikëve për të cilat F.Z. kishte deklaruar se janë të tijat.

▪ Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datë 14.02.2023.

- Nga ky vërtetim mbi sekuestrimin e sendeve është konstatuar se substanca e sekuestruar dyshohet të jetë e llojit marihuanë në peshë prej 7.7 gram.

▪ Lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës e datë 14.02.2023.

- Nga kjo listë shihet qartë pamja e përgjithshme e substancës së dyshuar narkotike, e cila gjendet në një qese plastike të tejdukshme e mbyllur e cila përmban një faculetë të bardhë dhe substancë bimore me ngjyrë të gjelbër, pesha neto 6.16 gram.

▪ Raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, i datë 27.07.2023.

- Nga ky vërtetim konstatohet se sipas analizave laboratorike, karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike kjo substancë përmban kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol me peshë neto prej 6.15 ± 0.0001 gram.

Gjendja faktike e vërtetuar nga ana e gjykatës

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, analizimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, si dhe shikimit në shkresat e lëndës vërtetohet kjo gjendje faktike: se i akuzuari me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka ndërmarrë veprimet inkriminuese për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Vlerësimi sipas ligjit i provave nga ana e gjykatës

Gjykata shqyrtoj me vëmendje të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atyre që gjenden në shkresat e lëndës dhe provave të cilat shfaqin lidhshmërinë e plotë të të pandehurit me veprën penale të kryer u fali besim të plotë, pasi që të njëjtat janë marrë në procedurë të rregullt ligjore, e sidomos gjykata u fali besim deklarimeve të dëshmitarëve – zyrtarëve policor N.Sh. dhe M.B., deklarimet e të cilëve janë në përputhje me njëra tjetrën dhe në përputhje me detyrën e tyre zyrtare, ashtu që të njëjtit kishin qenë duke kryer detyrën e tyre kur kanë hasur në veturën në të cilën gjendet i pandehuri dhe në detaje e sqarojnë mënyrën e të vepruarit të F.A.t, ku të dy dëshmitarët deklarojnë se e kishin parë duke e hedhur substancën narkotike nga dora, përkatësisht i qëndrojnë pran raportit policor të hartuar nga ana e tyre menjëherë pas ngjarjes, në të cilin raport ishte përshkruar në mënyrë kronologjike rrjedha e ngjarjes, veprimet e të pandehurit si dhe veprimet e ndërmarra nga zyrtarët policor të cilët edhe e kishin arrestuar të njëjtin.

Fajësinë e të pandehurit gjykata e vërtetoi me provë indirekte edhe nga deklarimet e vetë të pandehurit pasi që i njëjti edhe pse e mohon që substanca narkotike e gjetur tek këmbët e tij

kishte qenë e tij, në anën tjetër me rastin e marrjes në pyetje në stacion policor menjëherë pas ngjarjes deklaroi se është përdorues i rregullt i substancave narkotike dhe se ditën kritike kishin dashur “me pështjell ka një cigare” – (duke aluduar në konsumim të substancës narkotike). Gjithashtu në seancën e shqyrtimit gjyqësor me rastin e dëgjimit të dëshmitarëve – zyrtarëve policor të cilët e ri konfirmojnë raportin e përpiluar nga ana e tyre ku në detaje përshkruhet ngjarja si dhe të dy deklarojnë se ju kujtohet i pandehuri, pas përfundimit të deklaratës së tyre, i pandehuri deklaroi se nuk ka pyetje për dëshmitarët dhe as nuk i kundërshton deklaratimet e tyre, ani pse të njëjtit konfirmojnë se e kanë parë të pandehurin duke e hedhur nga dora substancën narkotike. Pra edhe pse i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, në anën tjetër nuk i ka kundërshtuar as mohuar deklaratimet e dëshmitarëve.

Gjykata në anën tjetër nuk mundi që të vërtetojë ndonjë fakt kontestues lidhur me të pandehurin nga deklaratat e dëshmitarit E.S., i cili në deklaratën e tij të dhënë në stacion policor përveç që kishte deklaruar se A.M. kishte qenë duke e përgatitur narkotikun kur kishin hyrë në veturë, kishte deklaruar se nuk e ka parë kush e ka hedhur narkotikun nga dora dhe nuk e dinte nëse sasia e narkotikut e gjetur tek ulësja e të pandehurit F.A. ishte e tij.

Gjykata pasi vlerësoj deklaratimet relativisht kundërthënëse të të pandehurit, përkundër faktit se i njëjti në fazën e marrjes në pyetje të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor kishte zgjedhur që të shfrytëzojë të drejtën e tij që të mbrohet në heshtje, gjeti se qëllimi i të njëjtit ishte vetëm që ti shmangte përgjegjësisë penale, ndërsa edhe pse kishte mundësi që të ofronte prova që do të vërtetonin pafajësinë e pretenduar të tij, përveç që ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, nuk ka ofruar asnjë provë dhe nuk ka bërë asnjë propozim që do ti kontribuonte këtij qëllimi, ose më saktë në asnjë formë nuk ka arritur ta provoj se nuk ka kryer veprën penale, e po ashtu deklarimet e tij se ai nuk e ka ditur se në veturë ka substancë narkotike dhe se ai nuk e ka hedhur nga dora me tu ndalur nga zyrtarët policor, bien ndesh edhe me provat që gjykata i ka nxjerrë dhe administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe me faktin se vetë i pandehuri kishte deklaruar se ishin mbledhur për të pirë narkotik.

Baza ligjore

Neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton formën themelore të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, ashtu që theksohet se: “*Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet*” ndërsa në paragrafin 3 thuhet se “*Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen*”.

Nga provat në shkresat e lëndës dhe provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, u vërtetua mjaftueshëm se i pandehuri ka ndërmarr veprimet ashtu siç përshkruhet në dispozitivin e aktakuzës, duke poseduar në mënyrë të paautorizuar narkotik të llojit marihuanë, elemente këto që paraqesin figurën e veprës penale nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat, por pa u kufizuar si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjeti moshën e tij relativisht të re, si dhe gjendjen e dobët ekonomike. Sa i përket rrethanave rënduese për të akuzuarin gjykata gjeti shkallën e përgjegjësisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje të lartë nga ana e të pandehurit. Si rrethanë tjetër rënduese gjykata ka marr edhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer nga i pandehuri si dhe faktin se i pandehuri ka qenë edhe më parë i gjykuar me aktgjykimet e formës së prerë dhe atë me aktgjykimet P.nr.113/18, i plotfuqishëm me datë 07.05.2018, P.nr.185/18, i plotfuqishëm me datë 07.03.2019, P.nr.395/2018, i plotfuqishëm me datë 18.11.2021, P.nr.506/20, i plotfuqishëm me datë 27.06.2022 dhe P.nr.130/2022, i plotfuqishëm me datë 17.11.2022.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përshkruara më sipër gjykata të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke gjetur se ky dënim me gjobë prej 600€ (gjashtëqind euro) si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajsh, është dënim adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe pasojave të shkaktuara si dhe se me këtë dënim ndaj tij do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së. Duke i pasur parasysh të gjitha këto nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me i butë ose me i rëndë.

Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata me këtë aktgjykim nuk vendosi për konfiskimin e substancën narkotike të llojit marihuanë, për shkak se e njëjta ishte konfiskuar me aktgjykimin P.nr.282/23, të datës 08.05.2024, me të cilin është gjykuar i pandehuri A.M., i cili gjithashtu ka qenë pjesëmarrës në rastin konkret dhe për të njëjtin pas pranimit të fajësisë ishte veçuar procedura.

Në këtë çështje juridiko-penale nuk pati kërkesë pasurore juridike.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.226/24, datë 18.02.2025

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Agron Maxhuni**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.